

STATUTI I SHOQËRISE TREGËTARE ME PËRGJËGJESI TE KUFIZUAR

“NETIBAL” SHPK

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Në Tiranë sot në datë 15/06/2021 ,në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe ligjet nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqeritë Trgetare”, me vullnetin e tyre të lirë, ortakët e shoqërisë:

- **Z. Artur Beqiraj**, I biri I Servet , lindur në Vlorë, më 03/08/1982 dhe banues ne Vlorë,Lagja 24 Maj ,Rr Enver Jaho,pallati 1756 kati i trete, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me leternjoftimin Nr.037314928 dhe Nr. Personal I20803081V
- **Z. Ardit Selmanaj**, I biri I Fatmir , lindur në Vlorë, më 11/06/1993 dhe banues ne Vlorë , Vlorë,Lagja 24 Maj ,Rr Enver Jaho,pallati 1756 kati i pare, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ,identifikuar me pashaporten Nr.BR4851088 dhe Nr. Personal J30611081L

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar, vendosen të hartoje këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtëme:

KREU II

EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar **“NETIBAL ” SHPK** me themelues **Z. Artur Beqiraj** dhe **z. Ardit Selmanaj**

NENI 3

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nëshkruara për kapitalin.

NENI 4

Shoqëria e ka seline e saj në ne **Rruga Frosina Plaku, Kompleksi “Homeplan” shk 7 ,Dyqani nr 5 , Nr pasurise 3/201 +7-N5,Tirane**.Me miratim te organeve të saj kompetente ajo mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH apo jashtë saj.

NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e vëprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

KREU III

O B J E K T I

NENI 6


Objekti i veprimitarisë së shoqërisë është:

Zhvillime Aplikacionesh per Pagesa Online; Tregtim dhe Dhenie me qera ndaj klienteve paketa Reseller Hosting meqellimin e rishitjes paketave webhost nga klienti; Mirembajtje teknike per servera, webhost, faqe interneti, programe kompjuterike, rrjete kompjuterike etj. Kryeja eregjistrimit, modifikimin dhe fshirjen e domain-eve .al.com.al .net.al .com .org .net.info, etj te gjitha tld; Sherbimedhe Konsulence IT në biznese dhe individë, si mirembajtjekompjuterash dhe rrjeteve kompjuterike, instalime softwarekompjuterike sipas kerkesave te klientit etj; Zgjidhje dhe Ndertime te rrjeteve te telekomunikacionit, servera dhewebsverer, rrjete intranet extranet; Prodhim dhe Tregtim brenda dhe jashte vendit te pajiseve kompjuterike; Tregtimi, shitja, blerja e makinerive per realizimin e qellimeve te mesiperme. Shitje, Blerje, shkembim, marrja ose dhenia meqira e pasurive te paluajtshme per zhvillimin e aktivitetit; Trajnine ne fushat e Teknologjise se Informacionit si IT, Programues, Dizajnues etj; Perfaqesi te konçpanive te huaja, per produktet apo sherbimet te cilat lidhen direkt apo indirekt Shoqerine. Projekte time dhe zbatime te ndryshme. Menaxhime dhe Rifreskime Informacionesh te Faqeve te Internetit te klienteve te shoqerise; Realizim sistemeshkompjuterike, realizim programesh kompiuterike, realizim sistemesh ERP, CRM, HR, etj. Import/eksport pajisjeshkompiuterike, elektronike, informatike, audiovizive, mjekesore, etj. Sherbime mirembajtjeje per pajisje kompjuterike dhe elektronike, programe dhe sisteme informatike. Sherbim suporti teknik 24/7 ndaj klientit dhe tetjereve. Ndertim i qendrave te te dhenave (datacenter) per interesa te shoqerise; Konsulence ne fushen e marketingut. Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqeria mund te kryeje dhe te realizoje cdo aktivitet qe lidhet direkt, indirekt, eshte si rrjedhim apo ka te beje me objektivat e renditura me siper qe te arrihet objektivi i Shoqerise. Realizim fushatash publicitare. Promovime dhe Marketing nepermjet email, marketing ne facebook, marketing ne google, marketing me SMS etj. Zhvillim dhepozicionim i faqeve te internetit ne vendet e para ne motorrete kerkimit (SEO). Tregtime te produkteve dhe sherbimeve te siperpermendura, si dhe ne kompjutere te vecanta, servera, printerë, aparatë telefonike dhe kopjim, aksesoreve te tyre dhe produkteve te konsumit; Aktivitetet e analizes, projektimin, zhvillimin, dokumentimin, instalimin esistemeve kompjuterike, te teknologjise kompjuterike dherrjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te lidhura; Të ushtojë aktivitetin e tij si subjekt i së drejtës tregtare në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit dhe komunikimet elektronike (T.I.K) ;

KAPITALI

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) Leke, i zotëruar nga keta ortak:



Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron	Shuma e kapitalit
Artur Beqiraj	55 %	1 kuotë	55 lek
Ardit Selmanaj	45%	1 kuotë	45 lek

NENI 8 **KUOTAT E KAPITALIT**

Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

NENI 9 **MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakevë brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që do j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gjëzojnë këtë të drejtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKR.

Kuotat janë të papjestueshme.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

A B

KREU IV

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 11 KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESË

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mblidhet sa herë që është e njivojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare". Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortatakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithëshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI 13 THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpala datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të

vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çeshtjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 14

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Artur Beqiraj**, I biri I Servet, lindur në Vlorë, më 03/08/1982 dhe banues ne Vlorë, Lagja 24 Maj, Rr Enver Jaho, pallati 1756 kati i trete, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me leternjoftimin Nr.037314928 dhe Nr. Personal I20803081V

NENI 15 KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është **5 vjet**, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisi dhe nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç

parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturen e aparatit te shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

KREU V

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 16

Shoqëria “NETIBAL” SHPK prishet:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
- ç) me vendim të gjykatës;

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likuidimit emrit te shoqerise i shtohet pjesa “Ne likuidim” qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqeria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Pergjitheshme, kerkon çregjistrimin e shoqerise prane QKR, pas shperndarjes se aktiveve te mbeturat te shoqerise.

VITI FINANCIAR

NENI 17

Ne perputhje me ligjin shoqeria do te kete një register ne te cilen mbahen balance vjetore, raporte financiare vjetore dhe cdo kerkese tjeter ligjore.

NENI 18

Viti finanziar i shoqerise fillon ne 1 janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 dhjetor te po ketij viti me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti finanziar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon ne 31 dhjetor.

DIVIDENTËT

NENI 19

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si dividente, bazuar ne kuotat qe zoteron çdo ortak.



PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

NENI 20

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti, dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqeria do te kete vulen e vete ne te cilen shkruhet emri i shoqerise sic e prashikon ligji.

- 21.1 Per ato qe nuk jane parashikuar ne kete statut zbatohen dispozitat e e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Statuti eshte hartuar ne 5 (pesë) kopje originale me te njejten fuqi ligjore.


Ortakët e Shoqërisë

Artur Beqiraj



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Artur Beqiraj' with a stylized 'K' at the top left and a large 'A' at the bottom right.

Ardit Selmanaj



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Ardit Selmanaj' with a stylized 'A' at the top left and a large 'S' at the bottom right.